

VENDIM
Nr.434, datë 16.6.2011

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.269, DATË 28.4.2005
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR KRITERET DHE MASËN E
MBULIMIT FINANCIAR TË KUJDESIT SHËNDETËSOR PËR USHTARAKUN
E FORCAVE TË ARMATOSURA"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 40 të ligjit nr.9210, datë 23.3.2004 "Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.269, datë 28.4.2005 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 3 të bëhen shtesa dhe ndryshimi si më poshtë vijon:
 - a) në paragrafin e parë, pas fjalëve "...në institucionet shëndetësore ushtarake apo civile, publike...", të shtohen fjalët "...brenda vendit...".
 - b) paragrafi i dytë hiqet.
2. Në të gjithë tekstin e pikës 4, pas fjalëve "...institucione/institucionet shëndetësore...", të shtohet fjala "...shtetërore...".
3. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
SALI BERISHA